

VENDIM
Nr.35, datë 21.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË
LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR KOMPANINË PUBLIKE TË GJENERIMIT,
METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME
SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE, METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË
TARIFAVE TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE METODOLOGJISË
SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME PAKICË TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, nenit 18, pika 1 germa “g”, dhe neni 26, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi u njoh me draftet e metodologjive të paraqitura,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të miratimit të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike, metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Çmimeve dhe e Tarifave, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e këtyre akteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta